



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA FUSHË-ARRËZ**

**Procesverbal -Tipi i kontrates - Pune**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashk dokumentat e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS – “Rikonstruksion vija vaditese e lagjes Mejdan, Fshati  
Kryezi”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**  
45262300-4 Punime betoni

44163130-0 Tuba kanalizimesh

**VLERA E FONDIT LIMIT – 2 750 000 ( dy milion e shtateqind e pesedhete mije ) leke pa tvsh**

Në bazë të nenit 77, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 39, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Fushë-Arrëz**, ka hartuar procesverbalin për argumenimin dhe miratimin e specifikimeve tenike dhe kriterëve për kualifikimin për procedurën e sipercituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

## **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

---

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

- a) Kopjet e çertifikuara të bilanceve për vitet 2021,2022 dhe 2023 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse e të konfirmuara nga ky autoritet, ky kriter konsideroet i permbushur nese operatoret ekonomike arrijne vleren e xhiros minimale, ne te pakten nje vit te periudhes se kerkuar.
- b) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2023.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Ligjin nr. 160/2020 "Per prokurimin publik" neni 77, pika 3, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 43 pika 4., sipas shtojces 7 pika 1 germa dh tek DST.

Përcaktimi i vitit të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

#### **2.3.1 Për te provuar pervojen e meparshme :**

- a) pune te ngjashme per nje objekt te vetem ne nje vlere jo me te madhe se 30% e vleres se perlllogaritur te ontrates qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjate pese viteve te fundit, nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.
- b) pune te ngjashme deri nje kufi, ku vlere totale monetare e puneve te kryera, e marre se bashku gjate pese viteve te fundit, eshte jo me e madhe se vlere limit e kontrates qe prokurohet.

### **Plotësimi i një prej kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

-Për të vërtetuar përvojen e mëparshme nga OE duhet të paraqiten:

a) vertetim te leshuar nga nje ent publik, per permbushjen me sukses te kontrates, ku te shenohen vlera, afati i perfundimit te kontrates dhe natyra e punes se bere, per te vertetuar permbushjen e sukseshme te puneve.

b) per pervojen e meparshme te realizuar me sektorin privat, kerkohet si deshmi, vertetim, per permbushjen me sukses te kontrates, ku te shenohen vlera, afati i perfundimit te kontrates dhe natyra e punes se bere, e shoqeruar me fatura tatimore dhe cdo lloj dokumenti tjeter, qe parashikohet nga legjislacioni ne fuqi, qe provon realizimin me sukses e puneve.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 dhe neni 55 pika 4 germa a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

**2.3.2** Operoret ekonomike duhet te disponojne licensat e nevojshme per zbatimin e kontrates..

**Licensa profesionale te shoqerisse lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates**

- Liçense per zbatim punimesh pikat **N.P.1, - Klasifikim A**
- Liçense per zbatim punimesh pikat **N.P.7, - Klasifikim A**
- Liçense per zbatim punimesh pikat **N.S.18, - Klasifikim A**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. neni 39 pika 6 germa a.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
N.P – 1 A	Punime Germimi	Percaktimet ne preventiv	A

N.P - 7 A	Furnizimi dhe vendosja ne veper e tubacioneve te ndryshme	Percaktimet ne preventiv	A
N.S- 18 A	Punime gjeodezike	Percaktimet ne preventiv	A

**2.3.3** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar stafin inxhinierik me kontratë pune të vlefshme, diplomë, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë, si më poshtë:

- Ing. Ndertimi/hidroteknik 1 (nje)

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 77 , pika 4, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 39 pika 6 germa c. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë nje liste personeli kryesor të nevojshme për te zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar dhe të pajisur me deshmi te kualifikimit te sigurimit teknik, të lëshuara nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, nga të cilët te pakten:

- Teknik ndertimi 2 (dy)
- Murator /Punonjes betoni 3 (tre)
- Saldator 1 (nje)

*Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik, (të vlefshme), si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë.*

- Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht **1 (nje) drejtues mjetesh**, te pajisur kontrata pune dhe me dëshmite perkatese dhe te jete ne listepagesat e shoqerise.
- Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar **8** punetore te thjeshte dhe te figuroje ne listepagesat e shoqerise .

Për drejtuesit e mjeteve duhet të paraqitet dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse, si dhe të figurojnë në list- pagesat e shoqërisë.

**Argumenti:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjim nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 77, pika 4, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 39 pika 6 germa c. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë nje liste personeli kryesor të nevojshme për të përmbushur me sukses kontratën.

Tekniket e ndertimit kontrollojne cilesin e shtresave para hedhjes se betonit, skuadrimin e kanalit, pikat e vendosje se prizave. Muratoret ose punonjesit e betonit kane per detyre shtrirjen e betonit, veshjen e kanalit, skuadrimin e prizave. Saldatori do te merret me montimin e aksesoreve te prizave dhe vendosjne e tyre ne pikat e paracaktuara. Puntoret e thjeshte qe ne pergjithesi jane per pergatitjen dhe transportin e betonit per ne segmentet ku do te realizohet veshja e kanalit.

Numri i puntoreve te thjeshte dhe specialisteve eshte ne funksion te volumeve te germimeve, shtreses se cakullit, volumit te pergatitjes se betonit, kohes se nevojshme per transportin e tij dhe per vendosjen e tij ne paretet e kanalit. Perlllogaritje t jane bere ne baze te asaj qe nje punetore i thjeshte per 8 ore leviz 5 meter<sup>2</sup> cakull, pergatit 4-5 m<sup>2</sup> beton dhe perdor per kushtet konkrete deri ne 10 m<sup>2</sup> . Meqenese kemi 10 priza uji nevoiten mesatarish 10 dite pune per pergatijen e tyre dhe 3 dite pune per montimin e tyre.

**2.3.5** Një punësim mesatar i të paktën 16 (gjashtembedhjete) personave të siguruar për periudhen Mars 2024 Maj 2024. Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë:

a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj dhe listepagesat e shoqerise.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 39 pika 6 germa ç. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve, njësia e prokurimit ka marrë parasysh numrin e punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit dhe afatin e kryerjes së punimeve të përcaktuar në dokumentet e tenderit.

**2.3.6** Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Makina transporti veteshkarkues minimumi 16 ton ton	në pronesi ose me qera	copë	1
2	Kamionçine	në pronesi ose me qera	copë	1
3	Betoniere dore	në pronesi ose me qera	copë	2
4	Rrezervuar uji minimum 5 mije litra	në pronesi ose me qera	copë	1

5	Mini fadrome	në pronesi ose me qera	copë	1
6	Moto gjenerator 3 fazor per saldime	në pronesi ose me qera	copë	1

Mjete dhe paisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 Per miratimin e rregullores ”Per sigurine ne kantier” i ndryshuar, si më poshtë vijon:

- Kokore minimumi 16 copë
- Jeleke Fosfoeshente minimumi 16 copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 1 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 2 copë

Mjetet e lartpërmendura duhet të jenë në pronësi ose me qera dhe ofertuesi duhet të paraqesë deklarinimin për disponimin e makinerive (sipas shtojcës 9) .

Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë se: makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 39 pika 6 germa d. Makinerite e transportit tete gjitha llojeve do te perdoren per transportin e inerteve te llojeve te ndryshme. Minifadroma do te perdoret per levizje e inerteve dhe ngarkimin e tyre ne sheshin e punimeve. Betoniere e dores do te perdoret per pergatitje e betonit, motogjeneratori do te perdoret per saldimin e prizave ne vendet e caktuara.

### 2.3.7 Kandidati ofertues duhet të paraqesë certifikatat e mëposhtme:

- ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë “ lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim.

- ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të ambientit “ lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim.

- ISO 3834-2; 2006 mbi “Sistemet e menaxhimit te cilesise ne saldime” lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.160, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 77, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 44 pika 3.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë, standartet për shëndetin dhe sigurinë në punë, si dhe standartet e menaxhimit të mjedisit. Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se: operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate, në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen, njësia e prokurimit ka kërkuar certifikatat e mësipërme për vërtetimin se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime.

Certifikatë ISO 9001 - 2015 “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, mundëson që shoqëria të punojë me standarde të cilësisë e cila mundëson implikimin në menaxhim, identifikimin e riskut dhe mundësive, sigurimin e konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, etj.

Certifikatë ISO 45001-2018 “Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë”, mundëson që çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

Certifikate ISO 3834-2; 2006 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë në saldim” lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. Inxhinier profili mjedis ujëra.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**